



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 11 Prot.

Datë 07.01.2021

V E N D I M

Nr. 1, datë 07.01.2021

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	Anëtare me kompetencat e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska,	Anëtare e Gjykatës Kushtetuese
Marsida Xhaferllari,	Anëtare e “ “
Fiona Papajorgji,	Anëtare e “ “
Altin Binaj,	Anëtar i “ “
Përparim Kalo,	Anëtar i “ “
Sonila Bejtja,	Anëtare e “ “

U mbledh në datën 07.01.2021, me sekretare Edmira Babaj, ora 10:00, me këtë rend dite:

1. Përcaktimi i procedurës së zgjedhjes së Kryetarit.
2. Përcaktimi i kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese për vitin kalendarik 2021.
3. Përcaktimi i kalendarit të çështjeve për Seancën Plenare dhe Mbledhjen e Gjyqtarëve.

Në përfundim të mbledhjes, bazuar në nenet 7/d, 13, pika “e” dhe 38 pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.8577/2000).

V E N D O S I:

1. Fillimin e procesit të hartimit të rregullave procedurale administrative, bazuar në nenin 7/d të ligjit nr. 8577/2000, të ndryshuar, për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
2. Autorizimin e anëtares Vitore Tusha, në cilësinë e gjyqtares më të vjetër në detyrë, të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e Kryetarit, deri në zgjedhjen e tij.

3. Caktimin e përbërjes së tri kolegjeve për vitin kalendarik 2021, sipas nenit 13, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577/2000, si më poshtë:

Kolegji 1: Gjyqtare Vitore Tusha
Gjyqtare Elsa Toska
Gjyqtar Përparim Kalo

Kolegji 2: Gjyqtare Vitore Tusha
Gjyqtare Fiona Papajorgji
Gjyqtare Sonila Bejtja

Kolegji 3: Gjyqtare Vitore Tusha
Gjyqtare Marsida Xhaferllari
Gjyqtar Altin Binaj

4. Caktimin e kalendarit të çështjeve për shqyrtim në Seancën Plenare dhe në Mbledhjen e Gjyqtarëve.


ANËTARE

/Marsida Xhaferllari/



ANËTARE


/Elsa Toska/



ANËTARE ME

KOMPETECAT E KRYETARIT

/Vitore Tusha/



ANËTAR

/Altin Binaj/




ANËTARE

/Fiona Papajorgji/



ANËTARE

/Sonila Bejtja/



ANËTAR

/Përparim Kalo/

